trainkos

PLANI I BUXHETIT

2012



Fushë Kosovë
Dhjetor 2011

Përmbajtja

Faqe

1. Hyrje.....2
2. Buxheti operativ për vitin 2012.....3
3. Investimet Kapitale 2012 5
4. Aneksi 1 (buxheti operativ – sqarimet).....6

1. H Y R J E

Kompania - Operim me trena i Hekurudhave të Kosovës "TRAINKOS SH.A" ka filluar së vepruari si kompani e ndarë më 1 Shtator, 2011. Procesi i ndarjes së Hekurudhave të Kosovës Sh.A në dy kompani të reja ka përcaktuar që veprimtaria kryesore e Trainkos Sh.A të jetë transporti. Transporti i mallrave dhe udhëtarëve është shërbim publik për të cilin është paraparë zhvillimi i biznesit sipas "Planit të Biznesit 2012" të diskutuar dhe aprovuar në nëntor 2011. Kjo strategji është e mbështetur në deklaratën e precizuar për misionin dhe vizionin e zhvillimit të biznesit të kompanisë për vitin 2012.

Vizioni

Të jemi prijës në transportin e mallrave e sidomos të industrive të rënda brenda vendit me një rritje të vazhdueshme për t'u zgjeruar në rajon, si dhe me shërbime konkurruese, komode dhe me saktësi të lartë të jemi zgjedhja e parë e udhëtimit për pjesën më të madhe të qytetarëve të vendit. Me qëndrueshmëri financiare dhe ngritje të vazhdueshme ku puna jonë të jetë burim i vazhdueshëm i besueshmërisë së klientëve tanë dhe krenarisë për ne.

Misioni

Të jemi bartës të zhvillimit ekonomik të vendit duke ofruar zgjedhje konkurruese të transportit dhe me punën tonë të përmirësojmë mirëqenien e qytetareve tanë.

Duke u bazuar në të dhënat historike, analizën e tregut, analizën e kapaciteteve teknike dhe analizën financiare janë përcaktuar objektivat e Trainkos Sh.A për vitin 2012. Resurset financiare për realizimin e këtyre objektivave janë strukturuar sipas burimit të krijimit të këtyre resurseve. Burimi kryesor është nga buxheti operativ, pra nga shërbimet për transportin e mallrave që krijohen nga kjo veprimtari kryesore që zhvillon Trainkos Sh.A. Nga ky burim i financimit në total nga shitjet për transportin e mallrave parashihen të realizohet shuma prej 3,446,644.00€.
Burim tjetër i financimit do të jetë edhe transporti i udhëtarëve, në total parashihen të realizohen 1,836,959.00€. Nga shitja e biletave parashihen të realizohen 245,000.00€, kurse nga subvencionet të aprovuara me Buxhetin e Kosovës për vitin 2012, në total do të jenë 1,591,959.00€. Subvencioni në shumën prej 1,091,959.00€ është për transportin humanitar, konkretisht për qarkullimin e TLL-së (Treni i Lëvizjes së Lirë). Kurse subvencioni prej 500,000.00€ është për mbulimin e humbjeve nga trenat tjerë që i ka në funksion Trainkos Sh.A. Nëse këtu e kalkulojmë edhe shumën prej 287,000.00€

që vjen nga ofrimi i shërbimeve tjera atëherë në total shitjet parashihen të realizohen në shumën prej 5,570,603.00€.
Të hyrat tjera jo operative janë buxhetuar në një kategori të posaçme në shumën prej 5,000.00€.
Për t'i realizuar shitjet nga veprimtaria e cekur më lart planifikohet të realizohet një kosto për shërbimet, konkretisht blerja e materialeve sipas kategorive shpenzuese adekuate. Kostoja totale e kësaj kategorie është 3,725,432.00€. Në këtë kategori bënë pjesë edhe pozicioni – qasja në binarë, kalkulimet e bëra janë bazuar në marrëveshjen në fuqi të vlefshme deri në fund të këtij viti në shumën 134,000.00€. Pra shuma e parashikuar për tërë vitin 2012 është **1,608,000.00€** (Konkretisht janë të precizuara: për transportin e mallrave 623,345.00€ dhe transportin e udhëtarëve 984,655.00€).
Duhet ta kemi parasysh që finalizimi i draftit dhe fillimi i zbatimit të Deklaratës së Rrjetit me ndryshime të dukshme nga këto kalkulime do të ndryshojë gjendjen e raporteve të aprovuara në mes të shitjeve dhe kostos së shërbimeve.

Buxheti i planifikuar për shpenzimet e stafit për vitin 2012 është 1,410,000.00€.

Te kategoritë shpenzuese adekuate për shpenzimet operative gjatë vitit 2012 është planifikuar të realizohet shuma prej 466,836.00€.

Dhe krejt në fund janë të prezantuar edhe planifikimi buxhetor për grupin e kategorive të shpenzimeve që i takojnë shpenzimeve administrative. Për këtë grupim janë planifikuar të shpenzohen 336,900.00€.

2. BUXHETI OPERATIV I TRAINKOS SH.A PËR VITIN 2012

A	Shitjet	
1	Transporti i mallrave	3,446,644.00
2	Transporti i udhëtarëve	1,836,959.00
3	Shërbimet tjera	287,000.00
	TOTAL - Shitjet	5,570,603.00
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve	
1	Derivatet dhe lubrifikuesit	1,281,912.00
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	38,000.00
3	Inventar dhe pajisje	125,780.00
4	Material harxhues	8,000.00
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	314,440.00
6	Qasja në binarë	1,608,000.00
7	Sigurimi i palëve të treta	20,000.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	321,500.00
9	Blerje/shpenzime të tjera	7,800.00
	TOTAL - Kostoja e shërbimit	3,725,432.00
C (A-B)	Fitimi (humbja) bruto	1,845,171.00
D	Të ardhurat tjera	
1	Të hyrat tjera jo operative	5,000.00

2	Mjetet e akumuluara	320,203.00
	TOTAL - Të ardhurat tjera	325,203.00
E	Shpenzimet e stafit	
1	Pagat dhe kontributet	1,357,500.00
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera	52,500.00
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,410,000.00
F	Shpenzimet operative	
1	Mirëmbajtje dhe riparimi i objekteve	53,700.00
2	Sigurimi fizik - Total	54,000.00
3	Shërbimet tjera	18,400.00
4	Shpenzimet logjistike	32,088.00
5	Energjia elektrike dhe shërbimet komunale	28,100.00
6	Sigurimi i palëve të treta	13,000.00
7	Donacionet e dhëna	2,400.00
8	Marketingu	62,798.00
9	Udhëtimet zyrtare	40,000.00
10	Telefonat dhe Posta	25,700.00
11	Shërbimet bankare	7,000.00
12	Tatimet	45,000.00
13	Pajisje elektronike	68,650.00
	TOTAL - Shpenzimet operative	450,836.00
G	Shpenzimet administrative	
1	Mbeturinat dhe shërbimet komunale	1,000.00
2	Inventar dhe pajisje	23,000.00
3	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	20,000.00
4	Material i zyrës	21,500.00
5	Material sanitar	17,200.00
6	Qiraja për objektet	24,000.00
7	Reprezentacioni dhe bufeja	16,000.00
8	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	50,000.00
9	Shpenzimet logjistike	23,200.00
10	Kontigjente	127,500.00
	TOTAL - shpenzimet administrative	323,400.00
H (C+D-E-F-G)	Fitimi (humbja) nga veprimtaria/operacionet	(13,862.00)
I	Shpenzimet e zhvlerësimit	
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që ndikojnë në koston e shërbimit	(1,388.520.00)
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që nuk ndikojnë në koston e shërbimit	(12,980.00)
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	(1,401,500.00)
J (H+I)	Fitimi (humbja) nga veprimtaria/operacionet pas zhvlerësimit	(1,415,362.00)

3. INVESTIMET KAPITALE PËR VITIN 2012

BURIMI I FINANCIMIT	Viti 2012 €
A) Buxheti operativ – TRAINKOS Sh.A.	473,000.00
B) Buxheti i Kosovës - BK	1,200,000.00
TOTAL INVESTIME KAPITALE	1,673,000.00

A) INVESTIMET KAPITALE PËR VITIN 2012 TË CILAT DO TË FINACOHEN NGA BUXHETI OPERATIV - TRAINKOS Sh.A.

Tabela më poshtë paraqet projektet kapitale të cilat do të financohen nga buxheti operativ i Trainkos Sh.A. Këto projekte janë të përfshira në kategoritë përkatëse në planin e shpenzimit.

Nr.	Projektet e financuara nga buxheti operativ i Trainkos për vitin 2012	SHUMA/€
1	Objekti i tërheqjes së trenave -riparim	32,000.00
2	Sistemi elektronik i kontrollit të naftës	40,000.00
3	Kompresorë për lokomotiva 661	25,000.00
4	Turbina për lokomotiva 661	45,000.00
5	Motorë tërheqës për lokomotiva Di3/661	35,000.00
6	Pajisje për testimin e frenimit të lokomotivave	52,000.00
7	Pajisje për testimin e shpejtësimatësve të lokomotivave	30,000.00
8	Pajisje për lokomotiva G1700	10,000.00
9	PG rregullator për lokomotiva 661	30,000.00
10	Pajisje për zbutjen e ujit për furnizim të lokomotivave dhe pajisje për furnizimi me vaj	12,000.00
11	Bateri për lokomotiva 661	12,000.00
12	Renovimi i kulmit të punëtorisë së lokomotivave	7,000.00
13	Material për lokomotiva Di3	8,000.00
14	Material për lokomotiva 661	10,000.00
15	Material për lokomotiva G1700	7,000.00
16	Material për lokomotiva MDD3	4,500.00
17	Material për trena motorikë	15,000.00
18	Riparimi i nyjës sanitare në torno	2,000.00
19	Renovimi i punëtorisë së vagonëve	5,000.00
20	Material për vagonë të mallrave	7,500.00
21	Material për vagonë të udhëtarëve	9,000.00
22	Papuçe frenuese për vagonë	15,000.00
23	Furnizimi me pirunjer me ngritje deri 4 ton	27,000.00
24	Riparimi i tornos	27,000.00
25	Riparimet e pajisjeve ne punëtori/kalibrimet	6,000.00
	TOTALI:	473,000.00

B) INVESTIMET KAPITALE PËR VITIN 2012 TË CILAT DO TË INVESTOHEN NGA BUXHETI I KOSOVËS

Nga Buxheti i Kosovës (BK) për vitin 2012 janë paraparë grantet për TRAINKOS Sh.A në shumën prej 1,200,000.00€. Kjo shumë është destinuar për projektet e precizuara më poshtë dhe zbatimi i mëtutjeshëm i këtyre projekteve ndërlidhet me vazhdimin e mbështetjes nga BK-ja për vitin 2013. Buxheti i vogël dhe i limituar si dhe mundësia për të zbatuar projektet na detyron që projektet t'i planifikojmë për dy vite e më tepër.

Përshkrimi	Viti 2012 €	Viti 2013 €
Riparimi gjeneral i lokomotivave	800,000.00	800,000.00
Riparimi i mesëm i trenave motorikë	400,000.00	400,000.00
Totali	1,200,000.00	1,200,000.00

4. ANEKSI 1
Buxheti Operativ - sqarimet

A. Shitjet – TOTAL: 5,570,603.00€

A. 1. Transporti i mallrave për vitin 2012 është i parashikuar të jetë 3,446,644.00€ dhe atë:

A. 1.1. Transporti konvencional – ku përfshihet transporti i mallrave me vagonë do të jetë 3,330,185.00€ dhe

A. 1.2. Transporti jokonvencional – ku parashihet transporti i mallrave me kontejnerë dhe kamionë do të jetë 116,459.00€.

A.2. Transporti i udhëtarëve për vitin 2012 është i parashikuar të jetë 1,836,959.00€ dhe atë:

A. 2.1. Transporti komercial i udhëtarëve – duke u bazuar në përvojën e viteve paraprake dhe politikave të aprovuara për vitin 2012 parashihet të jenë 245,000.00€. Këtu janë të kalkuluara të hyrat e planifikuara nga biletat për qarkullimin e trenave: TLL (Treni i Lëvizjes së Lirë), Treni i Shkupit dhe Treni i Pejës.

A. 2.2. Transporti i subvencionuar i udhëtarëve në total është 1,591,959.00€. Shuma prej 1,091,959.00€ është buxheti i ndarë nga Buxheti i Kosovës për vitin 2012. TRAINKOS Sh.A do të vazhdojë me ofrimin e shërbimeve të Trenit të Lëvizjes së Lirë edhe gjatë vitit 2012. Pra, këtu janë të përfshira kalkulimet për qarkullimin e TLL-së në bazë të lëvizjes aktuale (në vitin 2011), dhe lëshimit në qarkullim të trenit për Mitrovicë. Kurse për mbulimin e humbjeve nga qarkullimi i trenit të Shkupit dhe të Pejës me Buxhetin e Kosovës për vitin 2012 janë ndarë 500,000.00€.

A. 3. Shërbime tjera - shuma prej 287,000.00€ janë kalkulimet që janë për t'u paguar në emër të qëndrimit të vagonëve të huaj në territorin R. së Kosovës.

B. Kostoja e shërbimeve – TOTAL: 3,725,432.00€

Shpenzimet e mëposhtme janë shpenzimet që ndikojnë drejtpërdrejtë në koston e ofrimit të shërbimeve tona.

B. 1. Derivatet dhe lubrifikantët – 1,281,912.00€

Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: vajra për mjete lëvizëse – 60,000.00€ dhe 1,221,912.00€ naftë për për transportin e mallrave dhe për transportin e udhëtarëve.

B. 2. Energjia elektrike dhe shërbimet komunale – 38,000.00€

Kjo shumë parashihet të shpenzohet për: thëngjill për ngrohje të ndërtesave në tërheqje – 6,000.00€; blerja e ujit me bidona për tërheqje – 1,500.00€; energjia elektrike – 30,000.00€ dhe destilatorë për distilim të ujit të akumulatorëve – 500.00€.

B. 3. Inventar dhe pajisje – 125,780.00€

Kjo shumë parashihet të shpenzohet për: pajisjet e saldimit – 2,700.00€; pajisje për testimin e frenimit të lokomotivave - 52,000.00€; pajisje për zbutjen e ujit për furnizim të lokomotivave dhe pajisje për furnizim me vaj - 12,000.00€; rezervuar të ujit të zbutur – 8,000.00€; vegla pune për punëtori – 5,080.00€; pajisje pune për kontroll – 6,700.00€; instrumente për tension të lartë – 800.00€; furnizimi me pirunjerë me ngritje deri 4 ton - 27,000.00€; nxehëse elektrike - 150.00€; ormanë për personel – 500.00€; Vegla pune, çanta, bateri, etj – 7,050.00€ dhe xhokera, fshesa, makina thithëse, hekur për hekurosje, makinë larëse, etj – 3,800.00€.

B. 4. Material harxhues – 8,000.00€

Kjo shumë parashihet të shpenzohet për: rërë për lokomotiva - 3,000.00€; shirita për shpejtësi matës – 1,000.00€; material sigurimi-blomba – 4,000.00€.

B. 5. Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera – 314,440.00€

Kjo shumë parashihet të shpenzohet për: kompresorë për lokomotiva 661 – 25,000.00€; turbina për lokomotiva 661 – 45,000.00€; motora tërheqës për lokomotiva Di3/661 – 35,000.00€; pajisje për lokomotivën G1700 – 10,000.00€; PG rregullator për lokomotivat 661 – 30,000.00€; bateri për lokomotiva 661 – 12,000.00€; material elektrik – 5,100.00€; thyerje-dëmtime në punëtori – 6,700.00€; material për pastrim, pucfalla, pastrues për duar etj. – 2,800.00€; material për lokomotiva Di3 – 8,000.00€; material për lokomotiva 661 – 10,000.00€; material për lokomotivë G1700 – 7,000.00€; material për lokomotiva MDD3 – 4,500.00€; material për trena motorikë – 15,000.00€; llamarinë, bulona,etj – 3,600.00€; benzinë për trenin ndihmës – 240.00€; material për vagonë të mallrave – 7,500.00€; material për vagonë të udhëtarëve – 9,000.00€; papuçe frenuese për vagonë – 15,000.00€; riparim i tornos – 27,000.00€ dhe riparimet e pajisjeve në punëtori/kalibrimet – 6,000.00€; pajisje për testimin e shpejtësimatësve të lokomotivave – 30,000.00€.

B. 6. Qasja në binarë – 1,608,000.00€
Kjo shumë parashihet të shpenzohet për pagesën e qasjes në binarë kompanisë "INFRAKOS Sh.A" sipas kalkulimeve dhe marrëveshjes ekzistuese. Konkretisht janë të precizuara pagesat për qasje: për transportin e mallrave – 623,345.00€ dhe transportin e udhëtarëve – 984,655.00€.

B. 7. Sigurimi i palëve të treta – 20,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për sigurimin e palëve të treta – sigurimin e udhëtarëve – 20,000.00€.

B. 8. Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj – 321,500.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: shpenzime për tërheqjen e trenave nga HM – 41,500.00€ (trenat e mallrave - 30,000.00€ dhe tërheqja e trenit të udhëtarëve – 11,500.00€); shpenzimet e RIV-it – 263,000.00€ dhe fjetja-dëmtimi i vagonëve – 17,000.00€ (trenat e mallrave 14,000.00€ dhe trenat e udhëtarëve 3,000.00€).

B. 9. Blerje/Shpenzime të tjera – 7,800.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për qiranë në Volkovë – 7,800.00€.

D. Të ardhurat tjera – TOTAL: 5,000.00€

D. 1. Të ardhurat tjera – 5,000.00€.
Këtu është paraparë të realizohen të hyrat nga shitja e mbeturinave.

D. 2. Mjetet e akumuluara - 320,203.00€
Shuma e mjeteve të konfirmuara në të gatshme në banka – 320,203.00€.

E. Shpenzimet e stafit – TOTAL: 1,410,000.00€

E. 1. Pagat dhe kontributet
Në bazë të politikave të aprovuara për pagat dhe kontributet për vitin 2012 janë paraparë të jenë 1,357,500.00€ dhe

E. 2. Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera
Kapin shumën prej 52,500.00€. Konkretisht: rrobat mbrojtëse për punëtorë – 20,000.00€; shkollimi-trajnimi – 20,000.00€; shpenzime mjekësore për punëtorë (material medicinal) – 9,100.00€ dhe shpenzime për sigurim shëndetësor (lëndimet në punë) – 3,400.00€.

F. Shpenzimet operative – TOTAL: 450,836.00€

F. 1. Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve – 53, 200.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: riparimin e objekteve të tërheqjes së trenave – 32,000.00€; riparimi i kulmit të punëtorisë së lokomotivave – 7,000.00€; riparimi i lokacionit për pajisje testuese – 3,000.00€; riparimi i nyjës sanitare në torno – 2,000.00€; servisimi i dyerve industriale në punëtori dhe

torno – 1,200.00€; renovimi i punëtorisë së vagonëve – 5,000.00€ dhe vendosja e shenjave njoftuese – paralajmëruese në hallën e punëtorisë – 1,000.00€.

F. 2. Sigurimi fizik Total – 54,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për sigurimin fizik të objektit - 54,000.00€.

F. 3. Shërbimet tjera – 18,400.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: shpedicion – 2,400.00€ dhe shpenzime për shtypje të biletave, formularëve dhe librave – 16,000.00€.

F. 4. Shpenzimet logjistike – 32,088.00€
Kjo shumë është e paraparë të shpenzohet për shpenzimet e naftës për vetura - 32,088.00€.

F. 5. Energjia elektrike dhe shërbimet komunale – 28,100.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: thëngjill për ngrohje të objektit në MML - 2,000,00€; rryma elektrike në stacionin Volkovë – 4,100.00€ dhe rryma elektrike dhe ngrohja– 22,000.00€.

F. 6. Sigurimi i palëve të treta – 13,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: kontrollet shëndetësore sistematike – 6,000.00€ dhe sigurimi i veturave – 7,000.00€.

F. 7. Donacionet e dhëna – 2,400.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për sponzorimin e aktiviteteve të ndryshme brenda tërë vitit 2012.

F. 8. Marketingu – 62,798.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: konkurse dhe shpallje – 3,000.00€; publikime për prokurim – 3,000.00€; dhurata për pensionime – 5,000.00€; publikimi i orarit dhe urimi i festave të ndryshme në gazeta – 7,798,00€; transmetimet e spoteve ne radio - 12,000.00€; shtypja e reklamave, fllajerave, kalendarëve, fletushkave, etj - 22,800.00€ dhe dhuratat e fund vitit - 10,000.00€.

F. 9. Udhëtimet zyrtare – 40,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për udhëtime zyrtare për përfaqësim – 25,000.00€ dhe realizimin e projekteve - 15,000.00€, janë përfshirë Shpenzimet e hotelit, udhëtimet me aeroplan, mëditjet, shpenzimet për viza dhe udhëtimet lokale.

F. 10. Telefonat dhe posta – 25,700.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: konsumuese për telefona mobil 10,000.00€; konsumuese për telefona fikse dhe internet– 14,000.00€; posta dhe dërgesa për tërë vitin - arkiva (dërgesa postare) – 700.00€ dhe DHL - për tërë vitin (dërgesa urgjente – konfidenciale) – 1,000.00€.

F. 11. Shërbimet bankare – 7,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për provizionet bankare brenda vitit 2012 – 7,000.00€

F. 12. Tatimet – 45,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për pagesën e tatimeve në të ardhurat personale – 45,000.00€.

F. 13. Pajisjet elektronike – 68,650.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: pjesë për fotokopjues kompjuterë, printerë dhe të tjera - 10,800.00€; blerjen e fotokopjeve kompjuterëve dhe printerëve – 13,300.00€ aparat për FAX – 150.00€; sistemi elektronik i kontrollit të naftës – 40,000.00€; blerje të pajisjeve telefonike – 4,400.00€.

G. Shpenzimet administrative - TOTAL: 323,400.00€

G. 1. Mbeturinat dhe shërbimet tjera komunale 1,000,00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për pagesat për bartjen e mbeturinave - 1,000,00€.

G. 2. Inventar dhe pajisje – 23, 000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: material të imët për mirëmbajtjen e objektit të administratës **–** 1,500.00€; pajisje për pastrim të hapësirave të administratës – 3,000.00€; pajisje për zyre të nevojshme për adminstratë-tavolina, karrige, ormanë etj. - 18,500.00€.

G. 3. Konsulenca dhe auditimi i jashtëm – 20,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: auditimin e jashtëm të pasqyrave financiare - 10,000.00€ dhe shpenzime për konsulencë -10,000.00€.

G. 4. Material për zyrat – 21,500.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: konsumuese për zyrë (riparime të imëta) – 2,000.00€; material shpenzues për zyre – 16,000.00€ dhe pajisje të ndryshme elektrike për zyrë si dhe ndonjë prishje e mundshme në sistemin elektrik në administratë – 3,500.00€.

G. 5. Material sanitar – 17,200.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: material shpenzues medicional-ndihma e parë – 4,400.00€; deratizimi, dezinfektimi, dezinsektimi – 4,000.00€ dhe material për pastrim për të gjitha objektet e Trainkos-it – 8,800.00€.

G. 6. Qiraja dhe objektet – 24,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për objektin me qira për administratën – 24,000.00€.

G. 7. Reprezentacioni dhe bufeja – 16,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: reprezentacion për tërë kompaninë – 6,000.00€ dhe shpenzimet për bufe - 10,000.00€

G. 8. Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet – 50,000.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për obligime të mundshme të cilat mund të arrijnë nga kontestet gjyqësore – 50,000.00€.

G. 9. Shpenzimet logjistike – 23,200.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: regjistrimin e veturave – 3,000.00€; riparimin dhe servisimin e veturave - 20,000.00€ dhe shërbime tjera operative - 200.00€.

G. 10. Kontigjente – 127,500.00€
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: rezerva kontingjente të Kryeshefit Ekzekutiv – 115,000.00€ dhe rezerva për mungesa-vjedhje të mallit – 12,500.00€.

I. Shpenzimet e zhvlerësimit - TOTAL: 1,401,500.00€

I. 1. Shpenzimet e zhvlerësimit që ndikojnë në koston e shërbimit – 1,388,520.00€.
Këtu është përfshirë zhvlerësimi i aseteve dhe të tjerave që ndikojnë direkt te kostoja e shitjes – 1,388,520.00€. Duhet ta kemi parasysh se kalkulimet janë bërë në bazë të draftit të ndarjes së aseteve nga pasuria e ish-kompanisë Hekurudhat e Kosovës Sh.A dhe parashikimi për vitin 2012 - 1,388,520.00€.

I. 2. Shpenzimet e zhvlerësimit që nuk ndikojnë në Koston e shërbimit – 12,980.00€.
Kjo shumë e kalkuluar po ashtu me gjendjen e veturave sipas draftit të ndarjes së aseteve të HK-së – 12,980.00€.